



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 dhe nenit 38 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 31 janar 2012, miratoi këtë:

REZOLUTË

Për Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë

1. Duke njohur përparimin që ka bërë Kosova në vitet që nga Shpallja e Pavarësisë dhe përparimin që do të vazhdojë ta bëjë;
2. Duke mirëpritur vendimin e Grupit Ndërkombëtar Drejtues për të synuar përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë gjatë vitit 2012;
3. Duke besuar se Kosova është e gatshme të pranojë vendin e vet meritore në mesin e vendeve të pavarura të botës;
4. Të përkushtuar ndaj përmbushjes të të gjitha obligimeve që kontribuojnë në përfundimin e fazës së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë duke pasur parasysh parimet kyçe të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit me Kushtetutën dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës;
5. Të vetëdijshëm se Kosova gjithmonë ka arritur përparimin më të madh drejt synimeve kombëtare kur forcat politike dhe udhëheqësit janë bashkuar;
6. Zotohet solemnisht për përkrahjen dhe përkushtimin e vet të plotë për arritjen e shpejtë, të tërësishme dhe të suksesshme të këtij synimi kombëtar, posaçërisht kalimit me kohë të të gjitha amendamenteve kushtetuese dhe legjislacionit tjetër të nevojshëm për t'i dhënë fund mbikëqyrjes së pavarësisë;

7. Fton Qeverinë e Republikës së Kosovës, në konsultim të ngushtë me udhëheqësit e partive parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, anëtarët e Grupit Drejtues Ndërkombëtar dhe Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil, që me prioritet të përgatisë legjislacionin i cili është i nevojshëm për të kompletuar zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës, si dhe të përgatisë të gjitha amendamentet e nevojshme kushtetuese dhe legjislacionin shtesë dhe t'ia paraqesë këto Kuvendit jo më vonë së katër javë nga data e kësaj rezolute.
8. Në mbështetje të nenit 71 të Rregullores së Kuvendit, autorizon Komisionin e tashëm ad hoc për Reformën Kushtetuese që të përgatisë amendamentet kushtetuese për vlerësim nga Gjykata Kushtetuese si dhe të përgatisë amendamentet kushtetuese dhe amendamentet legislative për miratim përfundimtar nga Kuvendi i Kosovës.

Nr. 04- R- 05
Prishtinë, më 31 janar 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,


Jakup KRASNIQI

C.c

- Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën,
- Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar,
- Grupetve Parlamentare,
- Presidentes së Kosovës,
- Qeverisë së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.